



**Organizata jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE**

7 gusht, Prizren

**KOMUNIKATË
Trashëgimi kulturore, jo vendparkingje!**

Sot është finalizuar iniciativa “Trashëgimi kulturore, jo vendparkingje!” e konceptuar nga pjesëmarrësit e Shkollës së Aktivizmit Urban në kuadër të projektit “Rikthimi i Qytetit”. Kjo iniciativë ka për qëllim të potencojë problemin e parkimit të automjeteve në afërsi të objekteve të trashëgimisë kulturore (ndër të tjera në afërsi të Xhamisë Sinan Pasha, në afërsi të Urës së Gani Tadës, në afërsi të Muzeut Arkeologjik etj). Kjo praktikë përveç se kufizon qytetarët në lëvizje, dëmton rëndë imazhin e qytetit në përgjithësi dhe objekteve të trashëgimisë kulturore në veçanti. Parkimi në afërsi të perimetrit të objekteve të trashëgimisë kulturore pengon vizurat ndaj vlerave të trashëgimisë, qasjen në objektet kulturore si dhe ndikon në dëmtimin e peisazhit kulturor. Rrjedhimisht, kjo problematikë ndikon jo vetëm te qytetarët e Prizrenit por edhe te turistët dhe vizitorët e shumtë të qytetit tonë.

Lidhur me këtë problematikë, EC sot ka intervenuar në rrugën “Vatra Shqiptare”, e cila lidh Kompleksin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit si dhe Kompleksin e Marashit, duke vendosur pengesa në formë të ulëseve, të cilat do të zëvendësojnë automjetet e parkuara në këtë zonë edhe pse një gjë e tillë është e ndaluar. “Ulëset pengesë” shprehin revoltën për pengesën në lëvizje dhe në vizuara ndaj dy komplekseve të rëndësishme të trashëgimisë kulturore në Prizren si rezultat i mosveprimit të institucioneve ndaj qytetarëve të cilët parkohen në vend të ndaluar.

Ideja për protestën artistike ndaj vendparkingjeve në afërsi të objekteve të trashëgimisë kulturore është dhënë gjatë Modullit 1 të Shkollës së Aktivizmit Urban, të mbajtur në muajt prill – maj të këtij viti, gjatë së cilës të rinjtë pjesëmarrës të shkollës kanë patur rastin të aftësohen lidhur me principet e aktivizmit urban. Lidhur me porosinë që kjo iniciativë tenton të përçojë te institucionet përgjegjëse, përfshirë këtu Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Drejtorinë e Inspektoriatit dhe Policinë e Kosovës –Rajoni Jug, të Premten, datw 03.08.2018, nxënësit pjesëmarrës të Shkollës së Aktivizmit Kulturor kanë dorëzuar peticionin e nënshkruar nga 243 qytetarë.

Kjo iniciativë do të përcillet me iniciativat e radhës të dizajnuara në kuadër të Shkollës së Aktivizmit Urban. Veprimet e propozuara trajtojnë çështje të caktuara të komunitetit në qytet, dhe u takojnë fushëveprimeve të ndryshme me fokus në hapësirat publike.

Shkolla e Aktivizmit Urban është pjesë e projektit “Rikthimi i Qytetit” që në mënyrë specifike synon të avokojë për gëzimin e plotë të së drejtës mbi qytetin përmes një sërë platformash të aktivizmit. Nëpërmjet Shkollës së Aktivizmit Urban, projekti ofron një platformë edukimi dhe aktivizmi qytetar për të rinjtë, duke transformuar nxënësit e shkollave të mesme në qytetarë politikisht aktiv dhe social.

Projekti "Rikthimi i qytetit - E Drejta mbi Qytetin për grupet e nënpërfaqësuar të komunitetit në Prizren" përkrahët financiarisht nga National Endowment for Democracy.

OJQ EC Ma Ndryshe

Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren

Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, Prishtinë

www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org

+381 38 224 967 & +381 29 222 771